


NE ZGJEDHIM TË ARDHMEN TONË




NE, E ARDHMJA E VENDIT TONË

ARDITË (14), BLIN (13), LINDA (13), ERMAL (13), ENDRIT (13), ALBATRIT (13), EDISON (13)



Si erdhi, si është dhe si do të jetë demokracia?

Ne të rinjtë që po e shkruajmë këtë artikull, duam që informatat tona t'ua përcjellim të gjithë lexuesve tanë. Duam që t'iu informojmë më shumë rreth demokracisë. Ne jetojmë në shtetin tonë, Kosovën. Secili nga ne duam që shteti ynë të jetë i zhvilluar. Kosova ka



formë demokratike të qeverisjes. Demokracia është formë e qeverisjes e përhapur në shumë vende të botës. Për fat të mirë, këtë formë të qeverisjes e kemi edhe ne.

Fjala demokraci rrjedh nga gjuha greke, ku „demos“ do të thotë popull dhe „kratia“ do të thotë pushtet. Demokracia e ka zanafillën që nga antikiteti, më saktësisht, që nga viti 507 para erës së re.

Kjo formë është shumë e mirë, sepse na ofron zgjed-


hje të shumta në jetën e përditshme, mundësi për shprehje të lirë të mendimeve, barazi pa dallim moshe, race, feje, gjinie, etj. Populli me anë të zgjedhjeve të lira, zgjedh udhëheqësit e tij, të cilët do t'i përfaqësojnë qytetarët e vendit dhe interesat e tyre. Për këtë arsye quhet udhëheqje e popullit. Ne mendojmë se kjo është forma më e mirë e udhëheqjes së një shteti. Në këtë formë të qeverisjes, çdo njeri është vetëvetja, sepse ka zgjedhjet e veta të lira. Demokracia ndahet në: demokraci të drejtpërdrejtë dhe në atë përfaqësuese. Në Kosovë kemi demokraci përfaqësuese parlamentare. Ne, si e tashmja dhe e ardhmja e vendit tonë, secili me anë të profesioneve të veta do të kontribuojmë për zhvillimin e demokracisë. Kjo sepse ne jetojmë në demokraci dhe secili prej nesh ka mendime dhe dëshira të ndryshme.



Autorët e artikullit

PUSHTETI I BARABARTË

ERIONA (13), OLSA (12), RINESA (13), RREZON (12), ALTIN (13), BULENT (12)



Sot në Punëtorinë e Demokracisë mësuam gjëra të rëndësishme për demokracinë dhe ndarjen e pushtetit. Ato i kemi shkruar në këtë artikull

Më herët ka ekzistuar sundimi në formë të monarkisë, pra, sundimi i një personi. Monarku ka pasur pushtet absolut dhe pushteti trashëgohej. Nëse babai im do të ishte mbret dhe nëna ime mbretëreshë, unë do të isha princeshë, e më vonë mbretëreshë. Pra, pushteti do të trashëgohej tek unë. Mirëpo, për herë të parë në Greqi filloi të funksionoj demokracia. Të drejtat ishin të barabarta, sepse sundonte populli dhe këtu nuk ishte më në pyetje trashëgimia. Ky sundim filloi të shpërndahej dhe sot është i njohur në të gjithë botën.

Ne qytetarët e Kosovës, jemi të shumtë në numër dhe nuk kemi mundësi të marrim të gjithë vendime në mënyrë të drejtpërdrejtë. Prandaj, ne kemi mundësi që përmes votave të zgjedhim përfaqësuesit tanë. Këtë të drejtë, të drejtën për të votuar në procesin zgjedhor

e gëzojmë nga moshë 18 vjeçare. Ne zgjedhim deputetët e Kuvendit të Kosovës, kurse ata votojnë Kryeministrin, i cili zgjedh ministrat e kabinetit qeveritar. Kjo do të thotë se ne ua japim përkohësisht pushtetin tonë këtyre institucioneve. Ndërsa, ky pushtet që të mos abuzohet ndahet në tri degë. Ato janë: Pushteti Legjislativ, Pushteti Ekzekutiv dhe ai Gjyqësor. Pushteti Legjislativ përbëhet nga Kuvendi i Kosovës. Ai ka për detyrë të miratojë ligjet. Pushteti Ekzekutiv përfaqësohet nga Qeveria, Presidenti, Policia dhe FSK-ja. Detyra e tyre është që të zbatojnë ligjet, që janë miratuar nga Kuvendi. Në fund, kemi Pushtetin Gjyqësor, ku hyjnë gjykatat. Tri gjykatat në Kosovë janë: Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme. Ne mendojmë se ndarja e pushtetit është e rëndësishme, sepse ndahen punët e secilit institucion. Përveç se ndahen punët, zvogëlohen edhe mundësitë që pushteti të abuzohet dhe kjo forcon demokracinë tonë.



Ne respektojmë ligjet!



Nxënësit që punuan këtë artikull




„Demos-ti“




Dy kolegë gazetarë duke punuar



E drejta e strehimit



Një deputet dhe një deputete



Funksionet e Kuvendit



Gjatë përgatitjes së artikullit



Duke e shkruar artikullin me shumë zell



Puna në grup kërkon përkushtim

RËNDËSIA E KUVENDIT

KADRIJE (12), MALIKA (13), ERËZA (12), MUFAIL (12), TAULANT (13), RIAD (13)



Pa rregulla, asnjë shtet nuk do të mund të funksiononte. Këto rregulla janë ligjet. Mësojeni prej nga dalin ligjet dhe si hyjnë ato në fuqi

Për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, shteti është i rëndësishëm bashkë me rregullat që ai i përmban. Prandaj, ne kemi shumë rregulla në shtet, të cilat quhen ligje. Megjithatë, si do të mundeshim ne qytetarët e Kosovës, që në numër jemi afër 2 milionë banorë, të miratonim një ligj? Kjo do të ishte e pamundur. Për këtë arsye ekziston Kuvendi, i cili është edhe institucioni më i lartë demokratik dhe legjislativ. Lind pyetja se kush i miraton këto ligje në Kuvend? Epo, edhe kjo ka një përgjigje. Këto ligje i miratojnë deputetët, që në numër janë 120.

Ligjet janë shumë të rëndësishme për ne. Nga kjo kuptojmë se edhe Kuvendi është shumë i rëndësishëm në jetën tonë. Nëse mund të themi, madje edhe vetë jeta jonë varet nga Kuvendi. Kjo sepse, nëse Kuvendi miraton ligje të cilat janë jo të përshtatshme, prapëseprapë, ne duhet t'i zbatojmë ato. Si për shembull, nëse miratohet një ligj që thotë se duhet të qëndrojmë në shkollë edhe gjatë ditës së shtunë, ne duhet ta zbatojmë këtë ligj. Mirëpo, ne mendojmë se ky ligj nuk do të ishte i përshtatshëm për ne, sepse na mbetet pak kohë të përgatitemi në shtëpi, për të filluar javën e re në shkollë. Pra, një ligj i mirë na ruan jetën tonë. Shteti ynë është shtet demokratik, që do të thotë se ne si qytetarë marrim pjesë në qeverisjen e vendit.

Ne dhe Kuvendi jemi shumë të lidhur, kur bëhet fjalë për qeverisje. As Kuvendi nuk do të mund të funksiononte pa ne, por as ne nuk do të mund të jetonim pa ligjet që miratohen në Kuvend. Kuvendi ka funksionet e tij, ku nga shumë prej tyre, më të rëndësishme janë tri funksione. Funksioni i parë është funksioni legjislativ, sepse siç e thamë, Kuvendi bën miratimin ose jo miratimin e ligjeve. Funksioni i dytë është ai kontrollues, sepse Kuvendi kontrollon Qeverinë. Si dhe funksioni i tretë, por jo më pak i rëndësishëm, është funksioni përfaqësues, sepse aty deputetët na përfaqësojnë neve. Porosia jonë për të gjithë ju është pasi që të gjithë kemi të drejtën e shprehjes së lirë të mendimeve tona, ne duhet t'i respektojmë mendimet e të tjerëve dhe të respektojmë ligjet.



Autorët e këtij artikulli



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Ali Hadri“
Klasa: VII-1
Vendi: Mirash, Ferizaj